



OJQ “Kasneçët e Ardhmërisë” – KeA, është organizatë joqeveritare e cila zbaton projektin “Fuqizimi i Kontrollit të Tuberkulozit në Kosovë”, të financuar nga ana e GFATM nëpërmjet të CDF. Në lidhje me këtë projekt OJQ KeA hap thirrje për projekt propozime me titull:

Fuqizimi OJQ-ve nga radhët e komunitetit minoritar për zbatimin e aktiviteteve komunitare në fushën e vetdijësimin mbi Tuberkulozin dhe parandalimit të tij.

Qëllimi i aktivitetit:

Të fuqizohet komuniteti minoritar në komunat ku banojnë, me përfshirjen aktive në luftën kundër TB-së, përmes aktiviteteve ndërgjegjësuuese, edukative dhe mbështetëse për individët dhe familjet në rrezik.

Përshkrimi i përgjithshëm i projektit:

OJQ-ja përfituese do të zbatojë një projekt me kohëzgjatje prej 1 deri në 1.5 muaj, me buxhet maksimal deri në 1,000 € (njëmijë euro), që do të përfshijë aktivitete si:

- Sesione informuese në komunitet për njohjen e simptomave të TB-së;
- Distribui i materialeve edukative dhe sensibilizuese;
- Takime me liderë komunitarë;
- Aktivitetet mund të përfshijnë edhe angazhimin e vullnetarëve lokalë.

Kriteret e përzgjedhjes:

OJQ-të aplikante duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë të regjistruara në Kosovë dhe të përfaqësojnë komunitetin minoritar;
2. Të kenë përvojë në fushën e shëndetit publik ose punës me komunitete të marginalizuara;
3. Të posedojnë kapacitete për zbatim të aktiviteteve në terren;
4. Të paraqesin një propozim të shkurtër projekti (deri në 3 faqe) që përfshin qëllimin, rezultatet, aktivitetet, planin kohor dhe buxhetin e detajuar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari i aplikimit (në dispozicion në zyrën e OJQ KeA ose me email);
- Kopja e regjistrimit të OJQ-së;
- CV e shkurtër e organizatës;
- Lista e aktiviteteve relevante të mëparshme;
- Propozimi i projektit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më datë 25 tetor 2025, ora 16:00 në adresën elektronike: rinarexha28@gmail.com; me titull: “Ndërtimi i kapaciteteve dhe angazhimi i OJQ-ve komunitetit për të kryer aktivitete ACSM për TB”

Përzgjedhja dhe njoftimi:

OJQ-të do të vlerësohen nga një komision i OJQ KeA bazuar në përvojë, cilësinë e propozimit dhe rezultatet e pritshme. Vetëm OJQ-të e përzgjedhura do të kontaktohen për nënshkrimin e marrëveshjes.

Financimi:

Ky aktivitet financohet nga Global Fund (GFATM) përmes OJQ KeA, në kuadër të projektit kombëtar për kontrollin e Tuberkulozit në Kosovë.

Për më shumë informata:

OJQ KeA

Email: rinarexha28@gmail.com; xhevat.kurhasani@gmail.com

Tel: 044959636/044189640